

VENDIM
Nr. 290, datë 10.11.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s MBI LICENCIMIN
E SHOQËRISË “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P.)” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 13 dhe nenit 14, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1918/3 prot., datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Construction Energy Parts’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 264, datë 14.10.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.10.2022 dhe 17.10.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 24.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar në zbatim të rregullores. Nga shoqëria kërkohet që të dokumentojë mbështetjen financiare të saj, pasi letra e interesit me një bankë të nivelit të dytë e depozituar në ERE në kuadër të mbështetjes financiare mban datën 21.06.2022 dhe pas kësaj date nuk është depozituar ndonjë informacion, në lidhje me vijimin e kësaj procedure. Gjithashtu, shoqëria ka deklaruar se një pjesë të investimit do të kryhet nga zhvilluesi ndaj kërkohet të dokumentohet në ERE, nëse kompania vë në dispozicion të zhvillimit të këtij projekti të ardhurat financiare për mbulimin e pjesës së investimit që do të kryhet nga zhvilluesi.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është parashikuar dhe zgjatja e afatit për pranimin ose refuzimin për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për aplikuesin rast pas rasti, konkretisht: Pika 3. Bordi

mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit të përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë pune.

- Duke qenë se shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit të kërkuar nga Rregullorja, vlerësohet që të zgjatet me 20 (njëzet) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2 mw, duke i dhënë kështu mundësinë shoqërisë që të plotësojë dhe dokumentacionin e mbetur ende pa u plotësuar, i cili duhet të depozitohet brenda 10 (dhjetë) ditëve në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 20 (njëzet) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s mbi aplikimin e shoqërisë “Construction Energy Parts” (C.E.P.) sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

2. Shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P.)” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin e munguar brenda 10 (dhjetë) ditëve.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti